



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1639/1 Prot.

Tiranë, më 05/ 12/ 2018

V E N D I M

Nr. 246, Datë 05/ 12/ 2018

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, është paraqitur ankesa Nr. 181, datë 22.11.2018, e Fondacionit Down Syndrome Albania, përfaqësuar nga E. Z., ku pretendohet për diskriminim për shkak të *“aftësisë së kufizuar dhe përkatësisë në një grup të veçantë”*, nga ana e deputetit të Parlamentit të Shqipërisë A. H.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I :

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna, në formularin e ankesës, subjekti ankues deklaron se, A. H. në një postim në rrjetin social Facebook, ka akuzuar një tjetër deputet të Republikës së Shqipërisë, duke iu drejtuar me anë të gjuhës së urrejtjes dhe përdorur fjalën *“autik”*, si term fytes ndaj tij. Përdorimi i kësaj shprehje, me qëllime ofendimi, ka diskriminuar një grup të madh fëmijësh dhe të rriturish në mbarë botën.

Pala ankuese ka depozituar në cilësi prove, një printim të postimit të datës 19.11.2018, marrë nga faqja personale e facebook-ut të A. H., i cili ka cituar shprehimisht në postimin e tij drejtuar një deputeti tjetër të Republikës së Shqipërisë: *“Ç'faj ka familja jote “bamirëse” që ti vret çdo ditë etikën, estetikën, kulturën dhe moralin me fjalët dhe veprimet e tua prej autiku politik?! S'po ja del dot me fonde të dyshimta pikturash që të shërojë autizmin tënd.”*

Në përfundim të ankesës, përfaqësuesja e Fondacionit “Down Syndrome Albania” ka kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi të marrë masat e duhura në zbatim të Ligjit Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, për rastin në fjalë.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës u konstatua se:

Në nenin 1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në nenin 3, pika 1, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”*.

Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi ndalon situatat kur persona ose grupe personash në një situatë të njëjtë trajtohen në mënyra të ndryshme, dhe situatat kur personat ose grupet e personave në situata të ndryshme trajtohen njësoj.

Bazuar në nenin 7 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi apo mosveprimi si të një autoriteti publik, ashtu edhe çdo personi fizik apo juridik që merr pjese në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë.

Për sa më lart, lidhur me diskriminimin e personave të cilët janë diagnostikuar me autizëm dhe familjarëve të tyre, përmes gjuhës së përdorur nga A. H. në shkrimin e tij në profilin personal të facebook-ut, subjekti ankues i referohet një shkrimi të datës 19 Nëntor 2018.

Ndërkohë theksojmë që ankesa është paraqitur pranë Zyrës së KMD-së me datë 22.11.2018. Komisioneri, në të njëjtën datë në të cilën është paraqitur ankesa pranë Zyrës së tij, verifikoi sa më sipër pretendohet nga subjekti ankues dhe konstatoi se, shkrimi të cilit i referohet E. Z., mban po të njëjtën datë, 19 Nëntor 2018 (ora 09:06) dhe shprehimisht ndër të tjera citon se: *“Ç’faj ka familja jote “bamirëse” që ti vret çdo ditë etikën, estetikën, kulturën dhe moralin me fjalët dhe veprimet e tua prej autiku politik?! S’po ja del dot me fonde të dyshimta pikturash që të shërojnë autizmin tënd... E plot e plot të tjera o plak autik, që humbe shansin të ishe figurë historike dhe u katandise në mejhane shpifjesh dhe thashethemesh”*.

Rezultoi se vërtet A. H., (referuar materialit të printuar të shkrimit në profilin e tij të facebook-ut, sjellë nga pala ankuese) në po këtë datë ka përdorur termat e pretenduar në ankesë, por më datë 20 Nëntor 2018 (referuar verifikimit të faqes së tij të facebook-ut), në orën 10:46, është bërë prej tij korrigjimi i tekstit ku pretendohet se është përdorur gjuhë fyese ndaj personave të diagnostikuar me autizëm, duke lënë të kuptohet se e kishte vetëkorrigjuar.

U konstatua se më datë 20.11.2018, ka korrigjuar shkrimin në formën: *“Ç’faj ka familja jote “bamirëse” që ti vret çdo ditë etikën, estetikën, kulturën dhe moralin me fjalët dhe veprimet e tua të shfazimit politik?! S’po ja del dot me fonde të dyshimta pikturash që të shërojë sindromën tënde... E plot e plot të tjera o plak i çartur, që humbe shansin të ishe figurë historike dhe u katandise në mejhane shpifjesh dhe thashethemesh.”*

Gjithashtu nga verifikimi i bërë në mediat e shkruara, më datë 21.11.2018, Gazeta “Koha Jone” dhe Gazeta “Sot”, kanë publikuar shkrimin e A. H. dhe korrigjimin e bërë prej tij.

Referuar komenteve të cituara poshtë shkrimit të publikuar nga A. H., u vu re se ndërmjet tij dhe subjektit ankues kishte patur një diskutim rreth shprehjeve të përdorura në tekstin e këtij shkrimi, të cilat sipas subjektit ankues ishin ofenduese për të gjithë personat të spektrit autik dhe atyre me aftësi të kufizuara. Ndër të tjera në reagimin e E. Z. thuhej se: *“Ju bëni mirë të jepni menjëherë dorëheqjen për ofendim të të gjithë personave me çrregullime të spektrit të autizmit dhe aftësi të kufizuara dhe familjarëve të tyre...”*

Në përgjigje të komentit të sipërcituar, A. H. ka reaguar duke bërë ndyshimet në tekstin e shkruar prej tij, si dhe duke theksuar se: *“Përshendetje E. Z.! Në respekt të punës së palodhur që ju bëni, por edhe si nënë, si dhe duke besuar se dini të mos e përzieni misionin tuaj human me politikën, më lejo të sqaroj se komenti im në asnjë rast dhe askurrë nuk synon të fyejë ndokënd. Në asnjë diskurs politik sdo lejoja të përdorja përpjekjet dhe punën titanike të familjarëve të femijëve special apo me AK, shumë prej të cilëve i kam miq dhe e njoh nga afër betejën e tyre. Reagimi im ishte në mbrojtje të të drejtave të një qytetareje, një gruaje, një bashkëshorteje dhe një nëne që përgojohej pa të drejtë. Prisja që të solidarizoheshin të paktën zonjat aktive në jetën shoqërore, jo duke mbështetur postimin tim, por duke goditur shpifjen dhe baltosjen e grave në politik dhe angazhim social e shoqëror. Unë nuk reagoval për vete siç nuk kam reaguar fare edhe më parë kur jam etiketuar vetëm unë nga i njëjti personazh. Gjithsesi, në solidaritet dhe vlerësim për mijëra nëna dhe baballarë të femijëve speciale apo me AK, dashurive të medha të zemrës se tyrë, këtyre krijesave të mrekullueshme që ndoshta u vështirësojnë ditën, por u zbukurojnë jetën, që shumëshpesh shfaqin me shumë dashuri dhe mirësi se kushdo tjetër, nëse janë ndjerë sadopak të prekur apo fyer, qoftë edhe nga përdorimi letrar i termave, unë kam kurajon dhe moralin për të kërkuar ndjesë. Ndjesë po ashtu se sadoqë bashkë me kolegët e mi deputet kemi bërë shumë punë të mira për t’i ndihmuar, për të përmirësuar sadopak jetën e tyre, për të bërë një legjislacion më*

human dhe social, duke përmirësuar dhe lehtësuar arsimimin e këtyre fëmijëve me më shumë mësues special, duke rritur përkrahjen financiare për organet shtetërore dhe familjet e këtyre fëmijëve, përsëri nuk kemi bërë aq sa duhet, sepse mundemi dhe do bëjmë patjetër më shumë...Duke ju uruar suksese në misionin tuaj fisnik, ju garantoj se mirënjohjen dhe mbështetjen time personale, dhe jam i bindur edhe gjithë kolegëve të mi do e keni vazhdimisht. Disa sfida kapërcehen vetëm duke qënë së bashku.”

Njëkohësisht ky koment i A. H. i cili në thelb të tij është një ndjesë dhe tregon qartazi qëllimin jo fyes dhe poshtërues ndaj të gjithë personave me aftësi të kufizuar në përgjithësi dhe atyre me autizëm në veçanti, është publikuar edhe në portale e media me shikueshmëri kombëtare.

Pra, nga sa vërehet nga komenti i bërë, nga ana e A. H. ka patur një reflektim duke kërkuar ndjesë ndaj personave, grupeve apo familjarëve të prekur nga reagimi i tij në rrjetet sociale. Komisioneri është i mendimit se, jemi në kushtet kur subjekti kundër të cilit është paraqitur ankesa ka reaguar në mënyrë të menjëherëshme për termin e përdorur prej tij, duke e korrigjuar atë, si dhe duke kërkuar ndjesë po në faqen e Facebook-ut, ku është shprehur fillimisht.

Theksojmë se, Komisioneri ka patur dhe ka vazhdimisht në vëmendjen e vet, faktin që përdorimi i rrjeteve sociale për të bërë publike qëndrime verbale, opinione apo veprime konkrete të personave të caktuar publikë apo subjekteve të ndryshme politike, të jetë i kujdesshëm dhe të mos ndikojë negativisht apo si fyerje ndaj asnjë komuniteti apo grupi vulnerabël.

Ushtrimi i lirisë së shprehjes përmban në vetvete detyrime dhe përgjegjësi. Sipas paragrafit të dytë të nenit 10 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, ushtrimi i kësaj lirie nuk mund të çenojë dinjitetin dhe të drejtat e të tjerëve. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, ka theksuar në gjykime të ndryshme se: *“Toleranca dhe respekti për dinjitetin e barabartë të të gjitha qenieve njerëzore përbëjnë themelet e një shoqërie demokratike dhe pluraliste. Duke qënë kështu, si çështje parimore mund të konsiderohet e nevojshme në disa shoqëri demokratike që të sanksionojnë ose madje të parandalojnë të gjitha format e shprehjes që përhapin, nxisin, promovojnë ose justifikojnë urrejtjen e bazuar në jo tolerancë ..., me kusht që çdo “formalitet”, “kusht”, “kufizimet ose gjokat” janë proporcionale me qëllimin legjitim të ndjekur. (Erbakan v. Turkey, Aktgjykimi i 6 korrikut 2006, § 56)”. Duke qënë kështu lind nevoja e parandalimit të të gjitha formave të shprehjes të cilat përhapin, nxisin, promovojnë ose justifikojnë urrejtjen bazuar në mungesën e tolerancës.*

Gjuha e urrejtjes për qëllim të Rekomandimit CRI(2016)15 përfshin përdorimin e një ose të disa formave më të veçanta të shprehjes – si psh, mbrojtjes, promovimit apo nxitjes së denigrimit, urrejtje apo shpifje të një personi ose grupi personash, si dhe çdo ngacmim, fyerje, stereotip negativ, stigmatizim apo kërcënim i një personi ose disa personave dhe çdo justifikim të të gjithë formave të shprehjes - që është i bazuar në një listë jo shteruese të karakteristikave personale ose

statusin që përfshin "raca", ngjyra, gjuha, feja apo besimi, kombësia apo origjina kombëtare ose etnike, si prejardhja, mosha, aftësia e kufizuar, seksi, gjinia, identiteti gjinor dhe orientimi seksual¹.

Ligji nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, në nenin 3, pika 1, sanksionon: “Diskriminimi” është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”.

Në kuadër të ushtrimit të attributeve që i jepen prej Ligjit nr. 10221 datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, për të siguruar mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjellje që nxit diskriminimin, si dhe përmbushjes së qëllimit të ligjit nr. 10221 datë 04.02.2010, për të garantuar të drejtën e çdo personi për barazi përpara ligjit, mbrojtje të barabartë nga ligji dhe mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjellje që nxit diskriminimin, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka trajtuar edhe raste të tjera të gjuhës së urrejtjes nga persona publik.

Gjatë aktivitetit të tij, Komisioneri ka dënuar fuqimisht përdorimin e gjuhës fyese dhe intolerancës ndaj një komuniteti të caktuar, nga ana e individëve që bëjnë pjesë në jetën publike. Gjatë trajtimit të rasteve të ngjashme, Komisioneri ka kërkuar nga subjektet ndaj të cilëve është paraqitur ankesa, si masë rregulluese ndjesë publike në mënyrë që situata diskriminuese e pretenduar të marrë zgjidhjen e duhur e të mos përsëritet më në të ardhmen.

Për sa më lart, Komisioneri, vlerëson se në kushtet kur subjekti ndaj të cilit është paraqitur ankesa ka reaguar në mënyrë shumë të shpejtë duke kërkuar ndjesë publike dhe duke bërë modifikimin e statusit të publikuar në faqen e tij në facebook, nuk është e nevojshme që ankesa t’i nënshtrohet procedurave hetimore, pasi efektiviteti i veprimit për të cilin Komisioneri kryen veprimet e tij tashmë është arritur nga vetë subjekti A. H.

Për sa më sipër, ankesa e E. Z., nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj, pasi rezulton se qëllimi është përmbushur.

PËR KËTO ARSYE:

¹ Përkthim i Komisionerit. ECRI General Policy Recommendation No.15 “On combating hate speech” CRI (2016)15. Adopted on 8 December 2015. B.9 Definition (s).

Nga shqyrtimi i kësaj ankese dhe bazuar në nenin 33, pika 4/b të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës për shkak se është e papajtueshme me dispozitat e ligjit 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

(Shkaku: Aftësia e kufizuar dhe përkatësia në një grup të veçantë)

(Fusha: Të mira dhe shërbime)